



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 Tetor 2016
Nr. ref.:RK993/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI160/15

Parashtrues

Nehat Kelaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Panelit për lirim me kusht të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, PLKK 94/15, të 10 dhjetorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Nehat Kelaj nga Prizreni, aktualisht duke vuajtur dënimin me burgim në Qendrën Korrektuese në Dubravë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Njoftimin PLKK 94/15, të Panelit për lirim me kusht të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Paneli për lirim me kusht), të 10 dhjetorit 2015, si dhe Njoftimin e Qendrës Korrektuese në Dubravë, nr. 507, të 24 dhjetorit 2015, me të cilin parashtruesi i kërkesës është njoftuar se kërkesa e tij për lirim me kusht ishte e parakohshme.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës nuk cek konkretisht nene të Kushtetutës të cilët janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 30 dhjetor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 22 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 1 mars 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj Panelit për lirim me kusht.
8. Më 13 shtator 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Robert Carolan.
9. Më 15 shtator 2016, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues i rekomandoi Gjykatës në përbërje e plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

10. Parashtruesi i kërkesës është duke vuajtur dënimin me burgim në Qendrën Korrektuese në Dubravë.
11. Më 11 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës filloi iniciativën në Panelin për lirim me kusht për aprovimin e lirim të tij me kusht.

12. Më 10 dhjetor 2015, Paneli për lirim me kusht (me Njoftimin PLKK. 94/15) iu përgjigj parashtruesit se kërkesa e tij nuk është shqyrtuar, për shkak se ishte e parakohshme.
13. Paneli për lirim me kusht, theksoi se:
“Qendra Korrektuese e Dubravës ende nuk është parashtruar dosja juaj personale për shqyrtim ngase sipas ligjit ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese është kompetent për kontrollin e ligjshmërisë së kualifikimit ligjor të parashtrimit të kërkesave dhe rasteve për t’u trajtuar nga Paneli për lirim me kusht”.
14. Më 16 dhjetor 2015, parashtruesi kërkoi nga Qendra Korrektuese në Dubravë që t’i shpjegojë arsyet pse iniciativa e tij për lirim me kusht nuk i është përcjellë Panelit për lirim me kusht.
15. Më 24 dhjetor 2015, Qendra Korrektuese në Dubravë iu përgjigj (me Njoftimin nr. 507) parashtruesit të kërkesës se sipas KPK-së kërkesa për lirim me kusht shqyrtohet pas vuajtjes së 2/3 të dënimit të përgjithshëm, gjë që në rastin e parashtruesit do të thotë se kërkesa e tij nuk do të shqyrtohet para 11 nëntorit 2018.

Dispozitat përkatëse ligjore

LIGJI PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE

Ligji nr. 04/L-149

i 29 korrikut 2013

Neni 122

Paneli për lirim me kusht

[...]

5. Kundër aktvendimit të panelit për lirim me kusht nuk lejohet ankesa dhe nuk mund të ngritet konflikt administrativ.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës thekson se me vendimin e kontestuar:
“është shkelur e drejta themelore kushtetuese, në kundërshtim me nenin 3 të Kodit penal të Kosovës, si dhe nenin 250 LESP-së”.
17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai fitoi *“të drejtën e kualifikimit me ½ me kusht (...) me hyrjen në fuqi të Kodit Penal të ri neni 3, pika 1 dhe 2 [Zbatimi i ligjit më të favorshëm] lidhur me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale, neni 250”.*
18. Parashtruesi kërkon nga Gjykata të *“bëjë interpretimin e nenit 3 të kodit penal të Kosovës (...)”.*

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata shqyrton nëse kërkesa e parashtruesit i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

20. Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

22. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...]

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

23. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Paneli për lirim me kusht dhe shërbimi kompetent i Qendrës Korrektuese në Dubravë kishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, duke mos cekur asnjë nen konkret të Kushtetutës i cili ishte shkelur.

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se shkelja e të drejtave të tij kishte ndodhur si rezultat i interpretimit të gabuar të nenit 3 të KPK, në lidhje me nenin 250 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

25. Gjkata vëren se Paneli për lirim me kusht e kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës se *“Personi i dënuar ka të drejtë t'i paraqesë lutje për lirim me kusht panelit të themeluar në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës nëpërmjet institucionit korrektues në të cilin ai është duke e mbajtur dënimin”*.
26. Në këtë drejtim, Gjkata gjithashtu vëren se Paneli për lirim me kusht njoftoi parashtruesin e kërkesës se *“nga Qendra Korrektuese e Dubravës ende nuk është parashtruar dosja juaj personale për shqyrtim”*.
27. Gjkata më tej vëren se Qendra Korrektuese në Dubravë e njoftoi parashtruesin se *“për veprën penale të vrasjes për të cilën jeni dënuar, Kodi Penal i Kosovës parasheh aplikimin për lirim me kusht me 2/3 e dënimit që do të thotë se ju me datën 12.11.2018 e fitoni të drejtën e aplikimit”*.
28. Gjkata vëren se pyetja kryesore e parashtruesit është nëse ai ka të drejtë për lirim me kusht pasi të ketë shërbyer dy të tretat (2/3) e dënimit, në pajtim me Kodin Penal të mëparshëm, ose pasi të ketë shërbyer gjysmën (1/2) e dënimit, në pajtim me Kodin e ri Penal. Parashtruesi i kërkesës konsideron se, në pajtim me nenin 3 [Zbatimi i ligjit më të favorshëm] të Kodit të ri Penal, ai ka të drejtë për lirim me kusht pasi të ketë vuajtur gjysmën (1/2) e dënimit të tij.
29. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës ankohet se Paneli për lirim me kusht dhe Qendra Korrektuese në Dubravë kanë interpretuar gabimisht ligjin sa i përket plotësimin të kushteve ligjore për lirim me kusht dhe konsideron se ata do të duhej ta kishin interpretuar ndryshe dispozitën përkatëse ligjore.
30. Megjithatë, ai argument procedural ka të bëjë me fushën e ligjshmërisë dhe si i tillë nuk bie nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.
31. Në këtë drejtim, Gjkata thekson se interpretimi ligjor i ligjit të aplikueshëm për lirim me kusht është çështje e ligjshmërisë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga autoritetet publike, përveç dhe për atë sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë arsyetim procedural ose material në lidhje me shkeljet pretenduara kushtetuese.
32. Gjkata Kushtetuese gjithashtu thekson më tej se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo autoritetet tjera publike. Është roli i gjykatave të rregullta ose autoriteteve të tjera publike, kur është aplikueshme, që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28, shih gjithashtu rastin KI70/11 të Gjykatës Kushtetuese, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

33. Gjkata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
34. Gjkata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar asnjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave sipas Kushtetutës (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005).
35. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi që do të tregonin si dhe pse vendimet e Panelit për lirim me kusht dhe Qendrës Korrektuese në Dubravë që refuzojnë kërkesën e tij për lirim me kusht, shkelin të drejtat dhe liritë të tij të garantuara me Kushtetutë.
36. Gjkata vëren se rasti i parashtruesit është i ngjashëm me rastet e tjera tashmë të vendosura prej saj. Për shembull, në rastin nr. KI90/13 (parashtrues *Lumni Limaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 marsit 2014), kërkesa e parashtruesit për vlerësim të kushtetutshmërisë ishte refuzuar si qartazi e pabazuar pasi që Gjkata konsideroi se kërkesa nuk ishte arsyetuar *prima facie*.
37. Në fund, Gjkata konsideron se mospajtimi i parashtruesit të kërkesës me rezultatin e rastit, nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë të ngre kërkesë të argumentueshme për shkeljen e të "drejtës së tij themelore kushtetuese" (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI125/11, *Shaban Gojnovci*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 majit 2012, paragrafi 28).
38. Si përmbledhje, Gjkata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
39. Prandaj, Gjkata konstaton se, në pajtim me Kushtetutën dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (a), kërkesa është qartazi e pabazuar, si *prima facie* e paarsyetuar, prandaj është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi